Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-139534/26 dt.09.09.2026 në emër të aplikuesit/pronarit Festim Muli nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere për ndërtimin, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore - shtëpisë familjare me etazhitet P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU-së, në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914075-00125-16 ZK. Çagllavicë.
Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 23.10.2026 deri më 27.10.2026, në e-mail adresën: **urbanizmiprishtine@rks-gov.net.**

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Shtëpi individuale të banimit me etazhitet - P+1
b. Vija rregulluese	Për skaj rrugës ekzistuese
c. Vija ndërtimore c1. Ruga Publike c2. Anët – djathtas (AD) c3. Anët – majtas (AM) c4. Pasmë	Vija e ndërtimit jo më pak se 5 m për rrugë me gjerësi deri në 7 m / ~ 5m' nga rruga e eksiztuese *e propozuar* AM. 0.5 – 0.75h, e lejuar sipas PZHU-së /~3.0 m' *e propozuar* AD. 0.5 - 0.75h, e lejuar sipas PZHU-së /~1.0 m' *e propozuar me pëlqim nga fqiu* P. 0.5 -0.75h, e lejuar sipas PZHU-së /~3.0 m' *e propozuar*
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ 5.0m' / vija ndërtimore
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	AM / kufiri i parcelës kadastrale fqinje - 0.5h AD / kufiri i parcelës kadastrale fqinje - 0.5h P / kufiri i parcelës kadastrale fqinje - 0.5h
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	20-30 % e lejuar sipas PZHU-së/ ~ 28.01% *e propozuar*
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	60 - 80 % e lejuar sipas PZHU-së/ *~ 58.63 % e propozuar*
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% e lejuar sipas Vendimit të Kryetarit ~ 40% *e propozuar*
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	Vendimit të kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-185481 dt. 14.08.2015, është max. 60%; 0.00 % *e propozuar*
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	Minimum 1-VP për një njësi banimi
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.
Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.
Nënshkrimi i Zyrtarit: _____

Komuna e Prishtinës Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net